

V E N D I M
Nr.214, datë 28.3.1998

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 345
DATË 10.8.1992 “PËR SHPËRBLIMIN E PUNËS SË PUNONJËSVE”

Me propozimin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.345, datë 10.8.1992 “Për shpërblimin e punës së punonjësve” të bëhen këto ndryshime:

a. Në pikën 2, paga bazë minimale mujore bëhet 5800 lekë.

b. Për ndërmarrjet shtetërore dhe institucionet shtetërore jobuxhetore e pjesërisht jobuxhetore, paga mesatare e realizuar në muajin mars 1998, duke filluar nga data 1 prill 1998, rritet deri 20 për qind, sipas mundësive financiare të tyre. Në këtë rritje përfshihen edhe kompensimet.

c. Në pikën 7, në rreshtin e parafundit, raporti i pagave të jetë jo më i madh se 1:6.

d. Në pikën 8, paragrafi i parë ndryshohet si vijon: “Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë i sugjerohet të barazohet për efekt page me Ministrin e Financave. Drejtorët e bankave të nivelit të dytë, Drejtori i INSIG-ut, Drejtori i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shëndetësore barazohen për efekt page me Zëvendësministrin”.

e. Pika 8/1 ndryshohet si vijon: “Për shoqëritë aksionere me kapital tërësisht shtetëror pagat e drejtorëve caktohen nga organi, që ka në kompetencë emërimin e tyre. Raporti i pagës së drejtorëve, në krahasim me pagën më të ulët të punonjësve të këtyre shoqërive të jetë: Për shoqëritë aksionere deri me 200 punonjës, jo më i madh se 1:6, dhe për ato me mbi 200 punonjës jo më i madh se 1:7. Për Albbakrin, Albkromin, Albpetrolin, Gjeoalbën, KESH-in, Telekomin dhe AMC-në jo më i madh se 1.9”.

f. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.203, datë 4.5.1993 “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.345, datë 10.8.1992 “Për shpërblimin e punës së punonjësve””, pika 2 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrinë efektet financiare nga data 1 prill 1998.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano